



Pranuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivery	15.02	2022	2	viti god year
Organ /Hesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shlyca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKOVSHCK	789/2022		1/4	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1199/2021**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1199/2021 të datës 20.12.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë

e Ushqimit dhe Veterinarisë në Komunën e Prishtinës, kundër Vendimit me numër Nr.prot.12/2021 të datës 03.12.2021 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.02.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1199/2021 e datës 20.12.2021 e parashtruar nga ankuesi**

**II. MBETET në fuqi Vendimi me numër Nr.prot:12/2021 i datës 03.12.2021 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme.**

**A r s y e t i m**

Ministria e Punëve të Brendshme duke u bazuar në dispozitat e nenit 40 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenit 6 paragrafit 1.4 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2020 Për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e nëpunësve të Nivelit të Lartë Drejtues, fillimisht me datën 01.09.2021 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 30.10.2021 ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00007680 për pozitën e punës "Drejtor i përgjithshëm" në Zyrën e Kryeministrit-Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi Me datën 26.11.2021 Udhëheqësja e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit te Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka nxjerrë vendimin me numër Nr.prot.36/2021, sipas të cilit ankuesi është njoftuar se i refuzohet aplikimi për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës për shkak se i njëjti nuk është në pozitë të udhëheqëse të kategorisë së mesme apo të lartë drejtuese siç është përcaktuar me konkurs.

Kundër vendimit me numër Nr.prot.36/2021 të datës 26.11.2021 për refuzimin e aplikimit apo mos përfshirjen në listën e ngushtë nga ana e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik , ankuesi me datën 30.11.2021 ka parashtruar ankesë në Divizionin për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ne Ministrinë e Punëve të Brendshme. Udhëheqësja e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me datën 03.12.2021 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.prot.12/2021, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, me arsyetimin se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi se është në pozitë udhëheqëse të kategorisë së mesme drejtuese ashtu siç është kërkuar me konkurs.

Ankuesi kundër Vendimit me numër Nr.prot.12/2021 të datës 03.12.2022 përmes e-mailit zyrtar [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net) me datën 20.12.2021 ka dorëzuar ankesën me numër të protokollit 6230/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për mos përfshirje në listën e ngushtë nga ana e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ne Ministrinë e Punëve të Brendshme, pezullimin e rekrutimit për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë si dhe hapjen e konkursit të jashtëm për këtë pozitë lidhur me transparencën dhe mundësinë garuese të më shumë kandidatëve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.01.2022 ka nxjerr Vendim VK.nr.06/2022 me të cilin ka bërë shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës së ankuesit për 10 ditë pune.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot:6230/2021 të datës 20.12.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e datës 30.10.2021; Vendimin me numër Nr.prot.36/2021 te datës 26.11.2021 nga Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ne Ministrinë e Punëve të Brendshme; Vendimin me numër Nr.prot.12/2021 të datës 03.12.2021 nga Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ne Ministrinë e Punëve të Brendshme; CV-në e ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.01.2022 e parashtruar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 21.01.2022 nga Ministria e Punëve të Brendshme me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Aplikacionin për punësim të ankuesit

me numër të referencës RN00007680 të datës 12.11.2021 së bashku me provat e bashkangjitura në lëndë mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Njoftimin e datës 26.11.2021 nga Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ne Ministrinë e Punëve të Brendshme mbi përpilimin e listës se ngushte te kandidatëve aplikues; Ankesën e ankuesit të datës 30.11.2021 e parashtruar përmes e-mailit zyrtar tek Udhëheqësja në Divizionin për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Vendimin me numër VK.nr.06/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankuesit është e pabazuar, *sepse:*

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit për pozitën Drejtor i Përgjithshëm-Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, kanë qenë:

- *Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to: e preferuar ne fushe përkatëse ose te përafërt, te veprimtarisë se agjencisë;*
- *Se paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale , duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese.*

Bazuar në provat e lëndës ankuesi me rastin e aplikimit për këtë pozitë si dëshmi të përgatitjes së përvojës së punës ka dërguar: Vërtetimin e datës 02.11.2021 i lëshuar nga Menaxheri i Personelit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë me të cilin vërtetohet se ankuesi nga data 23.08.2013 mban pozitën si Udhëheqës i Sektorit të Bakteriologjisë dhe Parazitologjisë në Laboratorin e Ushqimit dhe Veterinarisë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; Vendimin me numër Nr.2/324 të datës 18.02.2004 nga Universiteti i Prishtinës sipas të cilit ankuesi është angazhuar në marrëdhënies pune me honorar për vitin akademik 2003/2004 për mbajtjen e lendeve Mikrobiologji e veçantë dhe Mikrobiologji me imunologji pranë Fakultetit të Bujqësisë; Kontratat e punës në Universitetin e Prishtinës -Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë për periudhën prej 01.10.2004 deri 30.06.2015 në pozitën e Asistentit.

Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ne Ministrinë e Punëve të Brendshme ,bazuar në kriteret e konkursit po ashtu edhe dëshmitë e bashkangjitura nga ankuesi, në pajtim me nenin 8 paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr.15/2020 Për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, ka bërë vlerësimin paraprak nëse kandidatët kanë plotësuar kushtet e konkursit, rrjedhimisht në bazë të kësaj ankuesi me vendim është njoftuar që i është refuzuar aplikimi me arsyetimin që nuk është në pozitë udhëheqëse të kategorisë së mesme apo të lartë drejtuese, si qeshte përcaktuar me konkurs . Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit te pretendimit ankimor të ankuesit se i njëjti edhe përkundër që dokumentacionin e ka pasur te kompletuar për këtë pozitë dhe i ka plotësuar kushtet, konstaton se në bazë të nenit 12 Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, janë përcaktuar saktë klasat dhe emërtesat e pozitave të punës



në kategorinë e ulët drejtuese, konkretisht kategoria e ulët drejtuese 2, ku theksohet se : *“Drejtues i Ulët 2 -2. Udhëheqës i Sektorit....”*, në të cilën hyn edhe pozita të cilën ankuesi e mban Udhëheqës i Sektorit të Bakteriologjisë dhe Parazitologjisë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, andaj edhe pretendimi i ankuesit që i njëjti i ka plotësuar kushtet e konkursit është i pabazuar.


Andaj pas gjithë këtyre, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Vendimi me numër Nr.prot.12/2021 i datës 03.12.2021 i Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, është nxjerrë në përputhje me nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me nenin 8 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2020 Për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues të Republikës së Kosovës, dhe nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe juridike.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.1199/2021**

Ardita Perçuku-ShYTI

  
Procesmbajtëse

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin e Menaxhimit të Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.